



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 149, Datë 28.05.2026

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “PREMIUM GREEN ENERGY” SH.P.K. NË  
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 13 dhe 14, pika 9, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1233/5 prot., datë 26.05.2026 dhe relacionin shtesë me nr. 1233/7, datë 28.05.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “PREMIUM GREEN ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “PREMIUM GREEN ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1233 prot., datë 21.04.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 122, datë 06.05.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 07.05.2026 dhe 08.05.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 18.05.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE, me shkresën nr. 1233/3 prot., datë 04.05.2026 dhe e-mailin e datës 14.05.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1233/4 prot., datë 18.05.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar.
- Nga analizimi i aplikimit rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e

*energjisë elektrike*”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.

- Për sa informuar nga vetë shoqëria, se struktura organizative do të bëhet efektive, me hyrjen në treg të shoqërisë vlerësohet që t’i lihet kushti që, me fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, të depozitohet në ERE informacionin e përditësuar në lidhje me këtë strukturë.
- Rezulton se shoqëria ka aktualisht një kontratë të vlefshme për disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit, por duket qenë se afati i saj përfundon më 14.05.2031 dhe nuk mbulon të gjithë periudhën 5-vjeçare të vlefshmërisë së licencës, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që brenda kësaj date të depozitohet në ERE kontratën e rinovuar për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument për disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “PREMIUM GREEN ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Brenda datës 14.05.2031, shoqëria duhet të depozitohet në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.
3. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “PREMIUM GREEN ENERGY” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**